

Mos t'i bëhen obstrukcione PPS-së, puna e saj është testi kryesor për demokracinë

Euroambasadori Aivo Orav po largohet nga Maqedonia me optimizëm se marrëveshja e Përzahinos do të zbatohet dhe se deri në fund të vitit në vend do të mbahen zgjedhjet, pas të cilave do të duhet doemos të bëhen reforma serioze. Në intervistën për MKD.mk ai flet për negociatat e katër partive politike, për mjetet financiare që nëpërmjet IPA-fondeve i jep Bashkimi Evropian, ndërsa abolicionin nga kryetari Ivanov e vlerëson si momentin më të vështirë për negociatat për dalje nga kriza.



Ambasadori Aivo Orav thotë se abolicioni ishte si një shpërthim nuklear që askush se kishte pritur dhe që shumë e vonoi dhe zgjati krizën, ndërsa do të mbahet mend dhe do të analizohet për një kohë të gjatë. Institucioneve të e shtetit iu rekomandon se duhet ta mbështesin PPS-në dhe Prokurorinë Publike, për shkak se vetëm ashtu mund t'i jepet fund krizës.

Po largoheni nga Maqedonia para se të shihni vallë do të realizohet marrëveshja, për arritjen e së cilës ndërmjetësuat edhe ju. A besoni se këtë herë partitë do ta mbajnë fjalën për atë që janë dakorduar, sepse përvoja e deritanishme tregon se kjo rrallë herë realizohet?

Procesi-Përzihino u përballë me shumë vonesa dhe shumë obstrukcione gjatë vitit të kaluar. Megjithatë shpresoj dhe pak-a-shumë jam i bindur se tani puna qëndron ndryshe, për shkak se marrëveshja e 20 korrikut është shumë e qartë. Ka disa elemente që duhet të realizohen para 31 gushtit, kur liderët do të takohen dhe do të thonë “po, çdo gjë është realizuar” dhe më vonë sivjet të shkohet në zgjedhje. Besoj se askush s’do të ketë kurrfarë arsytimi të tërhiqet nga kjo marrëveshje dhe shpresoj që kriza të merr fund këtë vit. Çështje tjetër është se çfarë do të ndodhë pas zgjedhjeve, sepse ky është vetëm një kapitull dhe ajo që duhet të bëhet janë reforma shumë serioze për të përparuar në drejtim të BE-së

Por edhe më parë ishte kështu, kishte marrëveshje, kishte afate, por nuk respektoheshin. Përse mendoni se tani do të respektoheshin krejt gjërat që janë dakorduar?

Besoj, për shkak se kjo marrëveshje është shumë e thjeshtë. Deri më 31 gusht duhet të kryhen dy punë. Një është Lista e votuesve. Procesi i pastrimit të listës është i ngadalshëm, por edhe mjaft stabil. Puna e dytë është pjesa e mediave, që është shkurtuar mjaft dhe është proces që mund të matet, që donë të thotë “po, këto dy punë janë kryer” ose “jo, këto punë nuk janë kryer”. Besoj se këto punë do të kryhen deri më 31 gusht.

Cilat janë rreziqet nëse partitë politike nuk i respektojnë afatet?

Në atë rast sërish do të ketë negociata pafund.

Kur t’i krahasoni marrëveshjet Përzihino 1 prej vjet dhe Përzihino 2 prej sivjet, cila marrëveshje u arrit më vështirë dhe përse?

Të dy marrëveshjet ishin të vështira, por Përzihino 1 ishte i ndryshëm sepse kishte të përfshirë më tepër aktorë dhe kishte më tepër improvizime. Nuk ishte fare e qartë se ku

do të ndalen partitë politike dhe çka saktësisht do të arrihet. Këtë herë ishte më lehtë, sepse është absolutisht e qartë se për kushtet duhet të pajtim të plotë, çka duhet të bëhet për të shkuar në zgjedhje dhe se këto kushte duhet të jenë të matshme. Kësaj radhe u deshtë të negociojmë më gjatë, pothuaj dy muaj, por sikurse edhe vitin e kaluar, problemi më i madh ishin konsultimet e gjata brendapartiake për të marrë pozicione para se të ktheheshin në tryezën e negociatave. Nevojitej vendosmëri, sepse vendimet e vështira nuk merren më lehtë nëse vetëm i shtyni.



A ishin partitë politike më bashkëpunuese vjet ose sivjet?

Varet. Të gjitha partitë kanë interesa të ndryshme, kujdesen për rejtingun e tyre, ashtu që kishim momente kur një parti ishte më bashkëpunuese dhe momente kur parti tjetër ishte më bashkëpunuese. Por , është interesant se gjatë dy javëve të fundit të negociatave të gjitha partitë ishin shumë bashkëpunuese, ndërsa katër përfaqësuesit të cilët negocionin me të vërtetë dëshironin të arrijnë rezultat. Dhe mendoj se kjo ishte pjesa më e mirë e negociatave.

Me cilën parti politike e patët më se lehti të bashkëpunoni?

Ka pasur momente nga më të ndryshme, por ajo që nevojitej dhe që kishte më së shumti rëndësi ishte të merren vendim e jo ato të shtyhen. Së dyti, nëse diçka

premtohet, edhe duhet të përmbushet dhe së treti respektimi i kohës së të tjerëve. Mos të lihet dikush “duke pritur zvarrë për shkak të konsultimeve, për shkak se kjo nuk është puna më e mirë. Kishte pritje e pritje të shumta për shkak të vendimeve partiake, Nuk do ta drejtoja gishtin kah askush, për shkak se ishte një proces shumë i gjatë, një vit dhe gjatë këtij procesi kishte momente nga më të ndryshmet. Por vjet kishte momente kur partitë shqiptare përpiqeshin të bëjnë presion për kompromis dhe t’i nxitin edhe dy partitë tjera. Do të thosha, në momente shumë kritike.

Çka ju pengonte te politikanët maqedonas?

Mendoj se si njerëzit, ashtu edhe politikanët gjithandej janë të ndryshëm. Disa e përmbushin premtimin, disa e respektojnë kohën e të tjetrit, disa janë më të vendosur. Është lehtë me ata që mund të marrin vendime, të cilët kanë mandat dhe të cilët janë të sigurtë.

Politikanët maqedonas i përmbushin premtimet ose jo?

Nëse dikush e dinë se nuk mund të përmbushë diçka, më mirë mos të premtojë.

A janë të vetëdijshëm politikanët maqedonas se çfarë janë pasojat për vendin nëse nuk lëvizin nga pozicionet aktuale?

- Gjithsesi se janë shumë të vetëdijshëm. Mendoj që e dinë se po të mos kishte marrëveshje do të ish pothuaj e pamundur që BE-ja sërish të jep rekomandim për fillim të negociatave. Por, ka edhe shumë për të bërë. Kuptohet se së pari (marrëveshja) duhet të implementohet plotësisht, por kjo nuk mjafton. Duhet të pasojnë reformat. Është humbur shumë kohë dhe tani duhet të mbërrihen fqinjët e sërish të fillojë bashkëpunimi normal dhe konstruktiv me BE-në.

Çka donë të thotë është humbur shumë kohë?

Donë të thotë se kriza politike po zgjatë dy vite nëse e llogaritni prej 24 dhjetorit, tanimë katër vite. Për fat të keq, gjatë këtyre viteve nuk kemi parë fare reforma. Vendet tjera kanë përparuar, ndërsa vendi juaj ngeci në vend. Ka shumë probleme në BE, shumë vështirësi jashtë BE-së, bota rreth nesh po ndryshon. Edhe vendi juaj edhe politikanët

duhet të vendosin nëse janë të bindur se BE-ja dhe NATO janë qëllimi i tyre primar, ndërsa për këtë nuk mjaftojnë vetëm fjalë, por duhen vepra.

Nuk po e shihni këtë tani?

- Atë që e shoh së paku është gatishmëria t'i jepet fund krizës, e më vonë do t'i vlerësojmë reformat që do të bëhen.



Cilat do të ishin pasojat për Maqedoninë në aspektin e procesit të eurointegrimi dhe me cilat sanksione ka mundësi të ballafaqohet?

- Nuk do ta kisha përdorë fjalën sanksione, për shkak se po flasim për vend kandidat për anëtarësim në BE dhe marrëdhëniet tona bazohen në supozimin se një ditë do t'i bashkëngjiteni BE-së. Nëse dëshironi ta bëni këtë ne e masim progresin.

Ç'është reduktimi i mjeteve financiare të IPA-fondeve, dënim, paralajmërim ose reduktim real i fondeve?

Reduktimi i mjeteve financiare të IPA-fondeve u bë para një muaji dhe ishte një shumë e madhe. Por më duhet të theksoj se BE këtu shpenzon 100 milionë euro në vit, që janë shumë para. Këto mjete kryesisht shkojnë në qeveri për infrastrukturë, për administratën publike, për ekologji, për bujqësi si dhe për shoqërinë civile. Një prej çështjeve kryesore është sundimi i së drejtës. Për fat të keq, para disa muajsh vërejtëm diçka mjaft interesant, befasi negative – abolicionin nga kryetari, e pastaj tërheqja e pjeshme e abolicionist. Kjo nuk është diçka që BE-ja e sponsorizon këtu, nëse flasim për konceptin e sundimit të së drejtës. Duam të shohim progres dhe kur u bë shkurtimi i IPA-fondeve kishte shumë arsye të ndryshme përse u bë ajo, por situata politike gjithsesi ishte një prej elementeve, qartë. Gjithashtu më duhet të them se deklaratat publike se BE-ja nuk jep para për vendin tuaj nuk janë fare të dobishme, sepse, siç thash, japim 100 miliona euro në vit.

Së dyti, nuk është e dobishme nëse BE-ja financon projekte të mëdha infrastrukturore, ndërsa nga mediat e kemi përshtypjen se këto para vijnë nga qeveria.

A po thoni se pjesa më e madhe shkojnë pikë së pari deri te qeveri. A i shfrytëzon qeveria këto para si duhet dhe për atë që janë dedikuar?

- Kur i japim paratë duhet të jemi të sigurt se do të përdoren në mënyrë korrekte. Nëse kemi dyshime bëjmë kontrolle, dërgohen inspektorë. Tani shumë para janë duke shkuar në gjyqësi, por i pamë problemet me reformat në gjyqësi, gjegjësisht si përdoren ato para. Pastaj erdhi abolicioni që vërtetë ishte diçka që shkaktoi shok. Kjo nuk është diçka që BE-ja mund ta pranojë ose ta kuptojë.

- Tani që e përmendët abolicionin, çfarë dëmi i shkaktoi vendit vendimi i kryetarit?

- Po flasim për vend-kandidat, ndërsa për t'ju bashkëngjitë BE-së dhe për të bërë progres do të donim të shohim reforma demokratike. Akti i kryetarit nuk mund të përfshihet në këtë kategori.

A e vlerësoni abolicionin si një episod të keq në politikë ose do të ketë pasoja më afatgjata për Maqedoninë?

Mendoj se do të mbahet mend dhe do të analizohet për një kohë të gjatë.



Kur flasim për kryetarin ai disa herë ka bërë vërejtje se politikanët maqedonas duhet më pak të shkojnë në ambasadat e huaja. Çka mendoni për këtë koment?

- Mendoj se do të ishte më mirë nëse kryetari i shtetit do të ishte ai që do të kishte ndërmjetësuar për zgjidhjen e krizës gjatë katër viteve të fundit.

Cili ishte momenti më i vështirë gjatë negociatave?

- Vjet ishte abolicioni. Ishte si një shpërthim bërthamor që askush se kishte pritur. Ai vendim e zgjati krizën shumë. Pastaj, kishte shumë momente kur nuk respektoheshin afatet, që shkaktonte shumë frustrime dhe sërish vonesa.

A pritni që Prokuroria publike speciale me të vërtetë do ta përfundojë punën për të cilën është formuar? A ka mundësi të ndodhë që ndonjë nga politikanët me të vërtetë të përgjigjet për gjërat për të cilat ngarkohet. Ashtu si po funksionon gjyqësia aktualisht vështirë se do të ndodhë kjo?

- Mendoj se politikanët nuk janë ndryshe nga njerëzit tjerë, prandaj nëse kanë bërë ndonjë gabim, edhe politikanët duhet t'i vuajnë pasojat. Përndryshe, këtu PPS-ja është temë shumë emotive dhe kjo është e kuptueshme. Ka shumë emocione, disa e mbrojnë, disa e sulmojnë, por nga aspekti i BE-së, zhvillimi i ngjarjeve rreth PPS-së dhe finalizimi i punës saj do të jetë një nga testet vendimtare për demokracinë. Jemi të shqetësuar për këtë dhe me shumë kujdes jemi duke e vëzhguar si do të vazhdojë ai proces.

Ju jeni të shqetësuar, por jo edhe gjyqësia...

Kur fola për reformat në gjyqësi kjo donë të thotë se ne i përcjellim edhe këto proces, e përcjellim se ç' bënte Gjykata Kushtetuese vitin e kaluar, si edhe gjykatat. Kishte kritika se u jemi "afruar" shumë gjykatave, por do të përkujtoja se duhet të vlerësojmë gjërat që i bëni di vend-kandidat që dëshiron t'i bashkëngjitet BE-së, ndërsa gjyqësia dhe sistemi gjyqësor është një prej punëve kryesore.

A mendoni se PPS-ja mund të punojë normalisht, siç është paraparë me formimin e saj?

Ka shumë vështirësi dhe mendoj se politikanët duhet të mundësojnë që puna e PPS-së, të gjitha institucionet shtetërore ta mbështetin PPS-në siç po e mbështetin Prokurorinë publike dhe vetëm kështu mund t'i jepet fund krizës. Me mbështetje mendoj të mos bëhen obstrukcione të punës së PPS-së, por sërish do të them se ka shumë emocione. Emocionet duhet të zhduken.

Keni kaluar gjatë kohë me politikanët maqedonas, mbase edhe më tepër se sa duhet. Tani në fund të mandatit tuaj në Maqedoni, si mund t'i vlerësoni politikanët maqedonas, si njerëz të cilët me të vërtetë kujdesen për vendin e tyre ose për partinë e tyre?

- Problemi këtu, e mbase edhe në vendet tjera të rajonit, është se pothuaj çdo gjë është e politizuar. Tepër. Çdo mbështetës ose anëtar i ndonjë partie është më i rëndësishëm se profesionisti. Ky nuk është problem i ri këtu, por ekziston me dekada. Etiketimet si tradhtar, spiun, armik shtetëror, përdoren tepër lehtë, ashtu që njerëzit të cilët kritikojnë menjëherë vendosen në anën tjetër të "frontit". Ekziston dallim nëse jeni nga partia "ime" ose i opozitës, për shkak se opozita konsiderohet si armik, për fat të keq. Nëse dëshironi të keni sistem të tillë, ndërkaq dëshironi të anëtarësoheni në BE, kjo donë të thotë se partitë që janë tepër të polarizuara, duhet të punojnë më afër, të ketë më shumë mirëkuptim të ndërsjellë dhe qasje të barabartë për BE-në. Tanimë e përmenda se dy javët e fundit të negociatave ishin shumë konstruktive. Përfaqësuesit kishin mandatin nga partitë të arrijnë marrëveshje, të gjejnë kompromis dhe kjo ishte përvojë unike që duhet të përhapet edhe jashtë Przhinos. Nëse punohet ashtu, mund të ketë progres.

Çfarë mendoni, pse ato dy javë ishin më bashkëpunues, a ka kjo lidhje me shkurtimin e IPA-fondeve?

- Të gjitha partitë kishin vendosur se duan marrëveshje sa më shpejtë. Ishte interesant të shikohet kjo. Secili dëshiron të arrihet marrëveshje, kuptohet kishte dallime të mëdha, por përfaqësuesit e partive përpiqeshin të ofrojnë zgjidhje duke marrë parasysh shqetësimet dhe perceptimet e të tjerëve. Kjo ishte shumë pozitive. Mirëpo nuk do të mund të konfirmoja nëse kjo kishte të bëjë me shkurtimin e IPA-fondeve.

Çfarë mësuar për Maqedoninë para se të vini, e me çfarë përshtypje po largoheni?

-Si ambasador BE-së erdha në vitin 2012, kurse paraprakisht kam qenë ambasador jorezident i Estonisë prej vitit 2005. E dija se do të jetë mjaft e vështirë për disa arsye, mirëpo nuk kam pritur sfida të atilla për punën time këtu. Nga pjesa e dukshme kam pasur paraqitje publike dhe isha pjesë e negociatave. Mirëpo puna e ambasadorit të BE-së është më e ndërlikuar. Koordinimi i aktiviteteve të vendeve anëtare të BE-së, pastaj IPA-fondeve, menaxhmentit të Delegacionit. Ato janë sfida, ndërsa interes kryesor e kisha t'i mbroj interesat e BE-së. Mendoj se pak a shumë kjo është bërë. Parimi im si diplomat është as të dua dikë, e as të urrej dikë. Vetëm në atë rast diplomat mund të jetë objektiv dhe shpresoj se ky parim është respektuar.



Cilat janë problemet më të mëdha për Maqedoninë?

Para pesë vitesh kishte vetëm një problem, kurse tani “menyja” është sundim i plotë i të drejtës, liria e mediave dhe dialogu politik. Tani hap-pas-hapi tryeza duhet pastruar nga të dy anët.

Megjithatë, një prej problemeve më të mëdha e konsideroj edhe ndotjen. Tani është vera dhe askush s'mendon për këtë, por nëntori vjen shpejtë. Ndotja e shkatërron shëndetin e njerëzve, sa të atyre të LSDM-së, aq edhe të atyre të VMRO-së.

A ju shqetësonin akuzat e disa politikanëve se Ju dhe ambasadori amerikan po përziheni pothuaj në çdo vend?

- Do të isha i lumtur ë ishte nevoja për këtë. Mirëpo t'ju përkujtoj vitin e kaluar paas Kumanovës askush në vend nuk mundej t'i bashkojë liderët e partive në tryezë të njëjtë. Ne e bëmë këtë bashkë me Xhes Bejllin dhe mendoj se ky ishte moment shumë kritik për shtetin. U shmang përkeqësim i mëtutjeshëm i situatës. Mund të spekulojmë çka ka mund të ndodhë nëse nuk do të takoheshin katër liderët dhe të apelonin për qetësi.

A nuk mendoni se në këtë situatë, në kohë të krizës së gjatë politike, çështja e emrit është lënë anash?

- Mendoj se kjo çështje deri tani ka qenë nën hijen e çështjeve tjera. Mirëpo çështja ende ekziston dhe është problem i madh. Shpresoj se pas zgjedhjeve, politikanët do t'i kthehen këtij kontesti.

Prej këtu shkoni në Mal të Zi. Çka pritni atje, mandat të stuhishëm sikur këtu ose do të keni më tepër kohë për të zbuluar plazhet e Malit të Zi?

- Edhe në Mal të Zi do të ketë sfida. Shteti është para anëtarësimit në NATO, negocion me BE-në, pra ambasadori i BE-së do të ketë më shumë rolin teknik. Duhet të shqyrtohen kapitujt, të kontrollohen shumë informata. Është e saktë se puna do të jetë ndryshe, që nuk donë të thotë se do të jetë më e lehtë. Tani kjo krizë politike u bë si punë rutine për mua.

Zhana P. Bozhinovska